



VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM  
DËLLIKA JE PRAVNOBESHTA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr. 824/16

30.06 2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtari individual Ilir Bytyqi si dhe me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani në lëndën penale kundër të pandehurve [redacted] nga Ferizaj dhe [redacted] nga Ferizaj, te akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/ II 58-5/16, të dt.29.08.2016, të cilët në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.15.05.2017 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/ II.nr.58-5/16, të dt.29.08.2016 dhe kjo gjykatë shqipton këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**Të pandehurit:**

1. [redacted] nga Ferizaj rr. "[redacted]", i lindur me [redacted] në fsh. [redacted] Komuna Kaçanik, nga i ati [redacted] dhe e ëma [redacted] e gjinisë [redacted] pa martuar, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. [redacted] nga Ferizaj rr. "[redacted]" i lindur me [redacted] nga i ati [redacted] dhe e ëma [redacted] e gjinisë [redacted] ndërtimtar, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesëm ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

Sepse me date 29.12.2015, rreth orës 12:30, në rrugën "Zgjimi" në Ferizaj, gjatë kontrollit nga ana e Policisë të Stacionit të Ferizajt, pas ndalimit të veturës "Fiat Punto" pa targë të regjistrimit, ngjyrë e kaltër të cilën veturë ka qenë duke e drejtuar i pandehuri [redacted] dhe i pandehuri [redacted] dhe dy pasagjeret [redacted] dhe [redacted], ku gjatë kontrollit në veturë është gjetur substance e dyshuar narkotike të llojit kanabis (marihuan) që

përmban tetrahidrokanabinol në peshë të përgjithshme 2.39 gram dhe një mulli për bluarjen e marihuanes si dhe një pako me letra "Rizlla" për mbështjellje të marihuanes, sasia e dyshuar është konfiskuar nga ana e policisë.

**me të cilën kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-se.**

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe nenit 495 të KPPK-së,

### **G J Y K O N**

Të pandehurit: 1. [REDAKTUAR] dënim me gjobë në shumë prej 200 €, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit: 2. [REDAKTUAR] dënim me gjobë në shumë prej 200 €, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1 (një) ditë burg.

Konform nenit 275 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit Marihuan me peshe të përgjithshme 2.39 gram.

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 40 € në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.58-5/16 të dt.29.08.2016, ka akuzuar të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për veprë penale posedimi i paautorizuar i

narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga të pandehurit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par. 1 të KPPK-së.

Gjykata me rastin e vlerësimit të provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si dhe raportit të ekspertizës të dt. 06.05.2016, deklaratat e dëshmitarit [REDAKTUAR] dt. 29.12.2015, deklaratat e dëshmitares [REDAKTUAR] dt. 29.12.2015, vërtetimi mbi sekuestrimin e perkoshem të sendeve dt. 29.12.2015 në emër të [REDAKTUAR] vërtetimi mbi sekuestrimin e perkoshem të sendeve dt. 29.12.2015 në emër të [REDAKTUAR] fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pjesërisht deklaratat e të pandehurve të sipërcekur, vërtetoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se tëi pandehurit janë kryes të veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtën e shpalli fajtores dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 40 € në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

#### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr.824/16 dt. 15.05.2016

Zyrtarja ligjore,  
Kadisha Shabani



30/05/2016

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.